

Raporti individual i konsultimit publik

1. **Titulli i projekt aktit:** “Për miratimin e Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Qëllimi i këtij projektvendimi është bashkërendimi, koordinimi dhe harmonizimi i përpjekjeve e nismave të të gjithë institucioneve në vend, duke krijuar kuadrin e nevojshëm për bashkëpunim ndërmjet të gjithë aktorëve, përmes roleve e përgjegjësi të tyre institucionale si dhe synon të përcaktojë orientimet politike që duhen ndërmarrë nga institucionet për parandalimin e të gjitha formave të kriminalitetit, duke bashkëvepruar me komunitetin për gjetjen e zgjidhjeve me qëllim rritjen e parametrave të sigurisë dhe adresimin e sfidave tek institucionet përkatëse në nivel qendror dhe vendor.

Gjithashtu, synon forcimin e qasjes gjithëpërfshirëse në parandalimin dhe trajtimin në kohë të problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet si uljen e kriminalitetit/sjelljeve anti-shoqërore në komunitet, uljen e veprave penale që cenojnë sigurinë në komunitet, parandalimit të orientuar nga intelijenca dhe informacioni, parandalimin dhe adresimin e problematikave në shkollë nëpërmjet ndëreveprimit me mësuesit, drejtuesit e shkollës dhe Policisë (SPZ), parandalimin nëpërmjet zbatimit të paketës së sigurisë në shkolla dhe rritjen e parametrave të sigurisë në komunitet nëpërmjet sigurisë rrugore dhe kontrollit të territorit.

Nisma për hartimin e këtij projekt-akti është ndërmarrë nga Ministria e Brendshme si institucion përgjegjës për fushën e rendit dhe sigurisë publike, bazuar kjo dhe në fushën e saj të përgjegjësisë të rregulluar me vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”. Gjithashtu, me Urdhrin nr. 20, datë 19.01.2024 të Ministrit të Brendshëm, “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Dokumentit Strategjik për Sigurinë Publike”, filloi puna për përgatitjen e projekt aktit.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar vazhdimisht takime të grupit ndërinstitutional të punës si dhe janë zhvilluar takime të tryezave teknike me përfaqësues të Policisë së Shtetit, konkretisht, Departamentit të Rendit dhe Sigurisë Publike, Sektorin e Krimeve në Volum, Sektorin e Policimit në Komunitet, Sektorin e Dhunës në Familje, Sektorin e Sigurisë Rrugore, Sallën e Komandës së Kontrollit, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me ekspertë në fushën e sigurisë publike nga organizatat si IDM, CIDS, dhe Programi Suedez për Policimin në Komunitet.

Ministritë e linjës, institucione të tjera si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit; Agjencia për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore; Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) kanë dhënë kontributin e tyre për hartimin e Planit të Veprimit 2023-2025.

Në vijim të sa më lart, projekt akti është publikuar për konsultim në RENJKP përgjatë periudhës 5 korrik 2024 deri në 2 gusht 2024.

Projekti i publikuar në RENJKP, pati 366 lexime dhe 1 koment në platformë.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Për të siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent në hartimin e projektvendimit “Për miratimin e Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026”, janë përdorur katër metoda të ndryshme konsultimi. Më poshtë gjeni një përshkrim të detajuar për secilën nga këto metoda:

1. Përdorimi i Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet prej datës 5 korrik 2024 deri në 2 gusht 2024, si një mënyrë e cila lejon qytetarët dhe palët e interesuara të paraqesin komente dhe sugjerime në lidhje me projekt aktin përmes internetit, duke siguruar akses të gjerë dhe transparencë në procesin e konsultimit;
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrin të Ministrit të Brendshëm nr. 20, datë 19.01.2024 të Ministrit të Brendshëm, “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Dokumentit Strategjik për Sigurinë Publike”. Këto takime përfshijnë mbledhje të grupit të punës të ngritur posaçërisht për hartimin e projekt aktit dhe diskutime të detajuara mbi politikat e propozuara.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike), si formë për të komunikuar me individë dhe organizata të interesuara në lidhje me projekt aktin, por gjithashtu edhe për shkëmbime të dokumenteve dhe komenteve midis anëtarëve të grupit të punës dhe titullarëve të institucionit;
4. Takime dhe tryeza teknike me përfaqësues të Policisë së Shtetit, konkretisht, Departamentit të Rendit dhe Sigurisë Publike, Sektorin e Krimeve në Volum, Sektorin e Policimit në Komunitet, Sektorin e Dhunës në Familje, Sektorin e Sigurisë Rrugore, Sallën e Komandës së Kontrollit, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me ekspertë në fushën e sigurisë publike nga organizatat si IDM, CIDS, dhe Programi Suedez për Policimin në Komunitet. Ministrinë e linjës, institucione të tjera si Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit; Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) kanë dhënë kontributin e tyre për hartimin e Planit të Veprimit 2023-2025.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Rendit, Sigurisë Publike dhe Çështjeve Vendore;
- Drejtoria e Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike;
- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore Për Çështjet e Brendshme në MB;
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Institucionet shtetërore të përfshira në Planin e Veprimit;
- Ekspertët e organizatave ndërkombëtare;
- Agjencia e Trajtimit të Shërbimeve (subjekt privat);
- Koordinatorin për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJKP.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Koment i përgjithshëm i cili nuk i referohet specifikisht aktit	“Punonjësit social dhe politikat sociale në Shqipëri janë lënë jashtë funksionit dhe duhet të merren masa që punonjësi social të jetë më afër familjeve”	Agjencia e Trajtimit të Shërbimeve (subjekt privat)	I refuzuar	Sqarojmë se, pranë të gjitha njësive administrative (bashki) ka punonjës social për çështjet e dhunës në familje, punonjës social për çështje të mbrojtjes së fëmijëve, të cilët kanë një koordinim dhe bashkëveprim të konsoliduar me punonjësit e policimit në komunitet, për referimin dhe

				trajtimin e rasteve. Gjithashtu, plani i veprimit për periudhën 2024- 2026, përfshin masa të cilat e përforcojnë rolin e këtyre strukturave përmes rritjes së kapaciteteve të tyre profesionale dhe procedurave të bashkëpunimit
--	--	--	--	---